

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

UNIVERSITETI “NËNË TEREZA” NË SHKUP
УНИВЕРЗИТЕТ „МАЈКА ТЕРЕЗА“ ВО СКОПЈЕ



B U L E T I N I
I
UNIVERSITETIT “NËNË TEREZA” NË SHKUP

Б И Л Т Е Н
НА
УНИВЕРЗИТЕТОТ „МАЈКА ТЕРЕЗА“ ВО СКОПЈЕ

Nr.39 / Бр.39

Shkup, 31 Janar 2022
Скопје, 31 Јануари 2022

Botim i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup
Издание на Универзитетот „Мајка Тереза“ во Скопје

Redaktor i veprimtarisë botuese të UNT-së / Уредник на издавачката дејност на УМТ:
Prof. Dr. Aziz Pollozhani, rektor

Redaktor i Buletinit / Уредник на Билтенот:
Prof. Dr. Mustafa Ibrahim

Këshilli redaktues i Buletinit / Уредувачки одбор на Билтенот:
Prof.Dr. Mustafa Ibrahim
Prof. Inor. Dr. Rizvan Sulejmani
Prof. Inor. Dr. Zoran Trifunov
Mr.Bujar Kajolli

PËRMBAJTJA / СОДРЖИНА

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS / ФАКУЛТЕТ ЗА ГРАДЕЖНИШТВО И АРХИТЕКТУРА

1. Referat për zgjedhje të një bashkëpunëtori-asistenti në fushën shkencore **Konstruksione ndërtimore në ndërtimin e ulët dhe të lartë (20702)**– (Mr. Besar Abdiu) 4-8
2. Referat për zgjedhje të një bashkëpunëtori-asistenti në fushën shkencore **Teoria e konstuksioneve (20706)** – (Mr. Lisa Jusufi) 9-18
3. Referat për zgjedhje të një bashkëpunëtori-asistenti në fushën shkencore **Normat në organizimin hapsinor (20102)** – (Mr. Valmir Dalipi) 19-25

FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE / ФАКУЛТЕТ ЗА ТЕХНИЧКИ НАУКИ

1. Referat për zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore– shkencore (thirrje të titulluar) nga fusha mësimore – shkencore Procedura Administrative Doganore (50832), E Drejta Administrative (50802) dhe Tjetër (50835) – (Dr. Valbona Hajretin) 26-38

REFERAT
PËR ZGJEDHJE TË NJË BASHKËPUNËTORI-ASISTENTI NË TË GJITHA THIRRJET
MËSIMORE-SHKENCORE NË FUSHËN SHKENCORE KONSTRUKSIONE
NDËRTIMORE NË NDËRTIMIN E ULËT DHE TË LARTË (20702) NË UNIVERSITETIN
„NËNË TEREZA”NË SHKUP

Në bazë të konkursit të Universitetit „Nënë Tereza” në Shkup, të shpallur me datë **01.07.2021**, në gazetën ‘Sloboden Peçat’ dhe ‘Koha’, për zgjedhje të një bashkëpunëtori-asistenti në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në fushën shkencore **Konstruksione ndërtimore në ndërtimin e ulët dhe të lartë (20702) dhe Materiale ndërtimore (20700)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore-hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit, dhe në bazë të Vendimit të Këshillit mësimor-shkencor, **nr. 0202-160/5**, të sjellë me datë **30.12.2021**, formohet Komisioni recensues në përbërje të:

Prof. Inor. Dr. Isak Idrizi	Profesor inordinar në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Universiteti Nënë Tereza – Shkup	kryetar
Doc. Dr. Semijal Hasani Ziberi	Profesor asistent në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Universiteti Nënë Tereza - Shkup	anëtar
Doc. Dr. Idaver Huseini	Profesor asistent në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara, Universiteti i Tetovës	anëtar

Si anëtarë të komisionit recensues, pas kontrollimit të dokumentacionit të dorëzuar paraqesim këtë:

RAPORT

Në konkursin e shpallur për zgjedhje të një bashkëpunëtori-asistenti në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në fushën shkencore **Konstruksione ndërtimore në ndërtimin e ulët dhe të lartë (20702) dhe Materiale ndërtimore (20700)**, në afatin e paraparë u paraqit kandidati:

- **Mr.Sc. Besar Abdiu**

1. TË DHËNAT BIOGRAFIKE DHE TË SHKOLLIMI

Kandidati Mr. Besar Abdiu është i lindur më 17 Nëntor 1992, në Tetovë. Shkollimin e mesëm e kreu në gjimnazin “Kiril Pejçinoviç” në Tetovë në vitin 2011. Arsimin e lartë e kreu në Fakultetin e shkencave të zbatuara të Universitetit shtetëror të Tetovës, në vitin 2016. Diplomoi në vitin 2016, me notë mesatare 8.59.

Kandidati në mënyrë aktive përdor gjuhën angleze. Brenda dokumentacionit të tij për konkurrim, ka dorëzuar dëshmi/certifikatë për mbarim të suksesshëm të kursit të gjuhës angleze.

Në vitin akademik 2016/2017 u regjistrua në ciklin e dytë të studimeve të masterit pranë institutit për inxhinieri të tërmeteve dhe sizmologji inxhinierike “IITSI” të Universitetit Shën Qirili dhe Metodi në Shkup. Studimet i përfundoi në vitin 2018, me notë mesatare 9.75. Në vitin 2018 mbrojti temën e masterit me titull: “Analiza dhe projektimi i strukturave optimale rezistuese ndaj tërmeteve me ramë BA në pajtueshmëri me Eurokodet dhe rregulloret e Maqedonisë”.

Menjëherë pas mbarimit të studimeve të ciklit të dytë (masterit), regjistroi studimet e ciklit të tretë (doktoraturës) pranë institutit për inxhinieri të tërmeteve dhe sizmologji inxhinierike “IITSI” të Universitetit Shën Qirili dhe Metodi në Shkup.

Në fund të vitit 2018 u përzgjedh në thirrjen asistent në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës pranë Universitetit Nënë Tereza në Shkup, në fushën Konstruksiione ndërtimore në ndërtimin e ulët dhe të lartë (me kod 20702 nga klasifikimi i lëmive sipas Fraskatit). Referati i fundit për zgjedhjen e kandidatit është shpallur në Buletinin nr.17 i datës 16 Nëntor 2018.

Deri më tani, kandidati ka treguar angazhim aktiv në studimet e doktoraturës. Kandidati ka dhënë numër të kënaqshëm të provimeve në studimet e doktoratës, me notë mesatare 10.00.

Komisioni recensues kishte parasysh realizimet e përgjithshme shkencore, profesionale, pedagogjike dhe realizime të tjera të kandidatit nga fillimi i karrierës, të shpallura në Buletinin nr. 17, si dhe realizimet e përgjithshme shkencore, profesionale, pedagogjike dhe realizime të tjera të kandidatit nga zgjedhja e fundit deri në ditën e konkurrimit në këtë konkurs (të paraqitura nga kandidati në kuadër të dokumentacionit të dorëzuar që janë të rëndësishme për zgjedhjen).

2. REALIZIMET SHKENCORE, PROFESIONALE, PEDAGOGJIKE TË KANDIDATIT NGAZGJEDHJA E FUNDIT DERI NË DITËN E KONKURRIMIT **Veprimtaria edukativo-arsimore**

Në kuadër të veprimtarisë edukativo-arsimore të UNT-së, në fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, kandidati Besar Abdiu mban ushtrime në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në programin studimor Ndërtimtari / Konstruksiione dhe në programin studimor Arkitekturë dhe Dizajn.

Aktivite tjera që kanë të bëjnë me veprimtarinë edukativo-arsimore, të rëndësishme për zgjedhjen, titujt e punimeve, projekteve etj, (me datë dhe të dhëna tjera të rëndësishme) paraqiten në formë tabelare në Shtojcën e këtij referati.

Veprimtaria kërkimore-shkencore/ Veprimtaria profesionale-artistike

Kandidati Mr.Sc. Besar Abdiu gjithsej ka botuar 5 punime shkencore nga fusha e inxhinierisë sizmike dhe konstruksiioneve ndërtimore, prej të cilave 0 punime shkencore në revista shkencore me impakt-faktor (faktor ndikues), 0 punime në revista shkencore ndërkombëtare dhe 5 punime në botime të konferencave ndërkombëtare, rajonale dhe vendore.

Kandidati ka qenë pjesëmarrës në konferencat e kaluara vjetore ‘TSD – Toward Sustainable Development’ të organizuara nga Universiteti Nënë Tereza në Shkup. Në suaza të këtyre konferencave, gjithashtu ka qenë prezantues i një punimi shkencor.

Kandidati ka qenë dhe mbetet i angazhuar në vazhdimësi në procesin e zhvillimit të literaturës së mirëfilltë për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies, proces të cilin fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës pranë Universitetit Nënë Tereza në Shkup e sheh si një prioritet shumë të lartë që nga themelimi i saj në vitin 2016. Më konkretisht, kandidati, si pjesë e një grupi punues, ka qenë i angazhuar për disa vite me përkthimin dhe shqipërimin e librit “Konstruksiione Ndërtimore Evropiane - me ilustrime” nga autori Francis Ching. Ky libër cilësor dhe me peshë ndërkombëtare është paraparë si literaturë bazë për zotërimin e lëndës “Konstruksiione Ndërtimore 1”, ku kandidati deri tani ka qenë i angazhuar si asistent. Ky libër gjithashtu është i paraparë të përdoret si literaturë për lëndët “Konstruksiione Ndërtimore 2”, dhe “Instalime Ndërtimore”.

Aktivite tjera që kanë të bëjnë me veprimtarinë kërkimore-shkencore, të rëndësishme për zgjedhjen, titujt e punimeve, projekteve etj, (me datë dhe të dhëna tjera të rëndësishme) paraqiten në formë tabelare në Shtojcën e këtij referati.

Veprimtaria profesionale-zbatuese dhe veprimtaria me interes më të gjerë

Kandidati, në kuadër të angazhimit të deritanishën në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës pranë Universitetit Nënë Tereza – Shkup, ka treguar angazhim aktiv në veprimtarinë me interes më të gjerë brenda fushëveprimit të fakultetit, përkatësisht:

1. Angazhim në procesin e regjistrimit të studentëve të rinj në programet studimore të fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës pranë Universitetit Nënë Tereza në Shkup.
2. Angazhim në aktivitetet promovuese të fakultetit
3. Angazhim aktiv në grupin punues për përgatitjen e elaboratit për riakreditim të dy programeve studimore të Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës pranë Universitetit Nënë Tereza në Shkup, përkatësisht të programeve Ndërtimtari – Konstruksione dhe Arkitekturë dhe dizajn.

Aktivitete tjera që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale-zbatuese dhe veprimtarinë e interesit më të gjerë, të rëndësishme për zgjedhjen, titujt e punimeve, projekteve etj, (me datë dhe të dhëna tjera të rëndësishme) paraqiten në formë tabelare në Shtojcën e këtij referati.

Vlerësim nga vetëvlerësimi

Kandidati Mr.Sc. Besar Abdiu, që nga viti 2018 ka marrë në vazhdimësi vlerësime pozitive nga anketat e zhvilluar në mënyrë anonime nga studentët e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës të Universitetit Nënë Tereza në Shkup.

PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Në bazë të dokumentacionit të përgjithshëm të dorëzuar si dhe njohjes personale të kandidatit, *Komisioni recensues vlerëson pozitivisht veprimtarinë edukativo-arsimore, kërkimore-shkencore dhe profesionale-zbatuese, si dhe veprimtarinë e interesit më të gjerë të kandidatit Mr. Besar Abdiu.*

Në bazë të të dhënave të paraqitura për aktivitetin e përgjithshëm të kandidatit nga zgjedhja e fundit deri më sot, komisioni përfundoi se Mr. Besar Abdiu ka cilësi të kënaqshme profesionale/shkencore sipas Ligjit për arsim të lartë dhe Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje të bashkëpunëtorit-asistent në Universitetin „Nënë Tereza” në Shkup.

Rrjedhimisht konstatojmë se kandidati *Mr.Sc. Besar Abdiu i plotëson të gjitha kushtet për zgjedhje në thirrjen asistent-doktorant në fushën shkencore ‘Konstruksione ndërtimore në ndërtimin e ulët dhe të lartë (20702)’.*

Sipas të lartpërmendurës, Komisioni ka nderin që Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës pranë Universitetit „Nënë Tereza” në Shkup t’i propozojë që *Mr. Besar Abdiu TË ZGJEDHET në thirrjen asistent-doktorant në fushën shkencore Konstruksione ndërtimore në ndërtimin e ulët dhe të lartë (20702).*

KOMISIONI RECENSUES:

Prof. Inor. Dr. Isak Idrizi Kryetar d.v. _____

Doc. Dr. Semijal Hasani Anëtar d.v. _____
Ziberi

Doc. Dr. Idaver Huseini Anëtar d.v. _____

SHTOJCA
DREJT RAPORTIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN
EDUKATIVO-ARSIMORE, MËSIMORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati: Besar Abdiu

Institucioni: Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Universitetin Nënë Tereza - Shkup

Fusha shkencore: Konstruksiione ndërtimore në ndërtimin e ulët dhe të lartë (20702)

VEPRIMTARIA EDUKATIVO-ARSIMORE

Nr.	Titulli i aktivitetit:	Pikët
1.	<p>Zhvillim i mësimit në: Ciklin e 1-rë të studimeve në Universitetin Nënë Tereza - Shkup</p> <p style="text-align: center;"><u>Programi Studimor: Ndërtimtari – Konstruksiione</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mekanikë - Statikë – Ushtrime (2021) x 3 orë x 0.9 pikë = 2.7 pikë 2. Materiale ndërtimore – Ushtrime (2018, 2019, 2020) x 2 orë x 0.9 pikë = 5.4 pikë 3. Konstruksiione ndërtimore – Ushtrime (2018, 2019, 2020, 2021) x 2 orë x 0.9 pikë = 7.2 pikë 4. Betoni i armuar – Ushtrime (2020, 2021) x 2 orë x 0.9 pikë = 3.6 pikë 5. Bazat e konstruksiioneve të çelikut – Ushtrime (2020, 2021) x 2 orë x 0.9 pikë = 3.6 pikë 6. Grafikë Inxhinierike – Ushtrime (2020,2021) x 2 orë x 0.9 pikë = 3.6 pikë <p style="text-align: center;"><u>Programi Studimor: Arkitekturë dhe dizajn</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Konstruksiione arkitektonike 1 – Ushtrime (2018, 2019, 2020, 2021) x 2 orë x 0.9 pikë = 7.2 pikë 2. Konstruksiione arkitektonike 2 – Ushtrime (2019, 2020, 2021) x 2 orë x 0.9 pikë = 5.4 pikë 3. Konstruksiione arkitektonike 3 – Ushtrime (2019, 2020, 2021) x 2 orë x 0.9 pikë = 5.4 pikë <p>Ciklin e 2-të i studimeve në Universitetin Nënë Tereza - Shkup</p> <p style="text-align: center;"><u>Programi Studimor: Ndërtimtari – Konstruksiione</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Beton i paranderë – Ushtrime (2019,2020) x 2 orë x 0.9 pikë = 3.6 pikë 2. Ndërtesa çeliku – Ushtrime 	51.3

	(2019, 2020) x 2 orë x 0.9 pikë = 3.6 pikë	
	Gjithsej	51.3

VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE

Nr. rendor	Titulli i aktivitetit:	Pikët
1.	Abstrakte dhe punime të botuara në konferenca vendore, rajonale dhe ndërkombëtare 5 x 1	5
	Gjithsej	5

VEPRIMTARIA PROFESIONALE-ZBATUESE

Nr. rendor	Titulli i aktivitetit:	Pikët
1.	Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit (2018-2021) 4 x 0.5	2
Veprimtari e interesit më të gjerë		
1.	Anëtar i komisionit të fakultetit për pranim studentësh (2018-2021) 4 x 0.5	2
	Gjithsej	4

REFERENCAT E KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE

VEPRIMTARIA	Pikët
VEPRIMTARIA EDUKATIVO-ARSIMORE	51.3
VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE	5
VEPRIMTARIA PROFESIONALE- ZBATUESE	4
Gjithsej	60.3

KOMISIONI RECENSUES:

Prof. Inor. Dr. Isak Idrizi Kryetar d.v. _____

Doc. Dr. Semijal Hasani Ziberi Anëtar d.v. _____

Doc. Dr. Idaver Huseini Anëtar d.v. _____

REFERAT
PËR ZGJEDHJE TË NJË BASHKËPUNËTORI-ASISTENTI NË TË GJITHA THIRRJET
MËSIMORE-SHKENCORE NË FUSHËN SHKENCORE TEORIA E KONSTRUKSIONEVE
(20706) NË UNIVERSITETIN „NËNË TEREZA” NË SHKUP

Në bazë të konkursit të Universitetit „Nënë Tereza” në Shkup, të shpallur me datë **01.07.2021**, në gazetat ‘Sloboden Peçat’ dhe ‘Koha’, për zgjedhje të një bashkëpunëtori-asistenti në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në fushën shkencore **Teoria e konstruksioneve (20706) dhe Tjetër (20720)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore-hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit, dhe në bazë të Vendimit të Këshillit mësimor-shkencor, **nr. 0202-160/5**, të sjellë me datë **30.12.2021**, formohet Komisioni recensues në përbërje të:

Prof. Dr. Zekirija Idrizi	Profesor në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Universiteti Nënë Tereza – Shkup	kryetar
Prof. Dr. Zhivko Bozhinovski	Profesor në Institutin për Inxhinieri të Tërmeteve dhe Sizmologji Inxhinierike - Universiteti Sh. Qirili dhe Metodi – Shkup	anëtar
Doc. Dr. Idaver Huseini	Profesor asistent në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara, Universiteti i Tetovës	anëtar

Si anëtarë të komisionit recensues, pas kontrollimit të dokumentacionit të dorëzuar paraqesim këtë

RAPORT

Në konkursin e shpallur për zgjedhje të një bashkëpunëtori-asistenti në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në fushën shkencore **Teoria e konstruksioneve (20706) dhe Tjetër (20720)**, në afatin e paraparë u paraqitën dy kandidatë (të listuar sipas alfabetit) si në vijim:

1. **Mr.Sc. Almir Rushiti**
2. **Mr.Sc. Lisa Jusufi**

1. TË DHËNAT BIOGRAFIKE DHE TË SHKOLLIMIT

Almir Rushiti	<p>Kandidati Mr.Sc. Almir Rushiti është i lindur më 15 Tetor 1993, në Kumanovë. Shkollimin e mesën e kreu në gjimnazin “Sami Frashëri” në Kumanovë në vitin 2012. Arsimin e lartë e kreu në Fakultetin e Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv në Universitetin “Sh. Qirili dhe Metodi” në Shkup. Diplomoi në vitin 2017, me notë mesatare 8.93.</p> <p>Brenda dokumentacionit për konkurrim, kandidati Mr.Sc. Almir Rushiti ka dorëzuar dëshmi/certifikatë për kalimin e testit APTIS të gjuhës angleze me notë B-. Ky lloj testimi është i nivelit më të ulët se IELTS dhe TOEFL dhe nuk ka njohjen e ndërkombëtarizuar të nivelit të IELTS dhe TOEFL.</p> <p>Në vitin akademik 2017/2018 u regjistrua në ciklin e dytë të studimeve të masterit në Fakultetin e Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv në Universitetin “Sh. Qirili dhe Metodi” në Shkup. Më 21.09.2018 mbrojti temën e masterit me titull: “<i>Rezistenca ndaj zjarrit e trarëve të vazhdueshëm nga betoni i armuar me zbatimin e Eurokodit 2 dhe metodave numerike</i>”, me çka i përfundoi studimet me notë mesatare 9.66.</p> <p>Menjëherë pas mbarimit të studimeve të ciklit të dytë (masterit), në vitin akademik 2018/2019 regjistroi studimet e ciklit të tretë (doktoratës) pranë Fakultetit të Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv në Universitetin “Sh. Qirili dhe Metodi” në Shkup. Në kuadër të këtij konkursi, Mr.Sc. Almir Rushiti nuk ka dorëzuar certifikatë të notave të provimeve të dhëna në ciklin e tretë, për të vlerësuar mbarëvajtjen e studimeve të tij të doktoratës përgjatë periudhës së kaluar trevjeçare (nga fundi i vitit 2018).</p> <p>Në fund të vitit 2018 u përzgjedh në thirrjen asistent në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës pranë Universitetit Nënë Tereza në Shkup, në fushën mësimore-shkencore “Të Tjerë” (me kod 20118 nga klasifikimi i lëmive sipas Fraskatit). Referati i fundit për zgjedhjen e kandidatit është shpallur në <u>Buletinin nr.17</u> i datës <u>16 Nëntor 2018</u>. Konstatohet se kandidati gjatë këtij konkursi ka konkurrar në fushë mësimore-shkencore të ndryshme nga ajo ku ka qenë i përzgjedhur deri tani.</p> <p>Përgjatë karrierës studentore, kandidati ka qenë edhe bursist nga fondacioni për bursimin e studentëve të Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës pranë Universitetit Sh. Qirili dhe Metodi, në Shkup, për suksesin e arritur gjatë studimeve në Fakultetin e Ndërtimtarisë në Shkup. Kandidati gjithashtu ka të shprehur interesim për anëtarësim në shoqata profesionale. Nga viti 2021 është anëtar i odës së Arkitektëve dhe Inxhinierëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut.</p> <p>Komisioni recensues kishte parasysh realizimet e përgjithshme shkencore, profesionale, pedagogjike dhe realizime të tjera të kandidatit nga fillimi i karrierës, të shpallura në Buletinin nr. 17, si dhe realizimet e përgjithshme shkencore, profesionale, pedagogjike dhe realizime të tjera të kandidatit nga zgjedhja e fundit deri në ditën e konkurrimit në këtë konkurs (të paraqitura nga kandidati në kuadër të dokumentacionit të dorëzuar që janë të rëndësishme për zgjedhjen).</p>
--------------------------	--

<p>Lisa Jusufi</p>	<p>Kandidatja Mr.Sc. Lisa Jusufi është e lindur më 03 Shkurt 1995, në Tetovë. Shkollimin e mesën e kreu në gjimnazin “Kiril Pejçinoviç” në Tetovë në vitin 2013. Arsimin e lartë e kreu në Fakultetin e shkencave të zbatuara të Universitetit shtetëror të Tetovës, në vitin 2016. Diplomoi më 28.09.2016, me notë mesatare 9.38.</p> <p>Në kuadër të dokumentacionit për konkurrim, kandidatja Mr.Sc. Lisa Jusufi ka dorëzuar dëshmi/certifikatë ndërkombëtare për kalimin e testit TOEFL që dëshmon zotërim të lartë të gjuhës angleze me notë 92/100. Testi TOEFL ka njohje të gjerë ndërkombëtare dhe gjerësisht njihet si lloji më i vështirë i testimit të nivelit akademik.</p> <p>Në vitin akademik 2016/2017 u regjistrua në ciklin e dytë të studimeve të masterit pranë institutit për inxhinieri të tërmeteve dhe sizmologji inxhinierike “IITSI” të Universitetit Shën Qirili dhe Metodi në Shkup. Më 06.09.2019 mbrojti temën e masterit me titull: <i>“Analiza jolineare e siloseve (guaskave cilindrike) nga betoni i armuar përmes Metodës së Elementeve të Fundme”</i>, me çka i përfundoi studimet me notë mesatare 10.00.</p> <p>Menjëherë pas mbarimit të studimeve të ciklit të dytë (masterit), në Tetor të vitit 2019 regjistroi studimet e ciklit të tretë (doktoraturës) pranë institutit për inxhinieri të tërmeteve dhe sizmologji inxhinierike “IITSI” të Universitetit Shën Qirili dhe Metodi në Shkup.</p> <p>Deri më tani, kandidatja ka dhënë të gjitha provimet nga studimet e saja të doktoraturës me notë mesatare 10.00, dhe tani është në proces të përcaktimit të temës së disertacionit të doktoraturës.</p> <p>Përgjatë karrierës studentore, kandidatja ka qenë dy vite rradhazi fituese e bursës dhe e mirënjohjes si studente e dalluar nga Universiteti Shtetëror i Tetovës, edhe atë për vitin 2014 dhe 2015.</p> <p>Në vitin 2016 ka qenë fituese e bursës për studime të suksesshme në ciklin e dytë (masterit) pranë Institutit për Inxhinieri të Tërmeteve dhe Sizmologji Inxhinierike (IITSI) pranë Universitetit Shën Qirili dhe Metodi në Shkup.</p> <p>Në vitin 2018 ka qenë fituese e bursës nga programi për shkëmbim të studentëve Erasmus+, në kuadër të së cilës ka qëndruar 1 semestër në Universitetin e Zagrebit ku të gjitha detyrimet (ligjërata, projekte semestrale dhe provimet) i ka mbaruar me sukses.</p> <p>Në vitin 2019 ka qenë fituese e bursës për vijim të suksesshëm të studimeve të doktoraturës pranë Institutit për Inxhinieri të Tërmeteve dhe Sizmologji Inxhinierike (IITSI) pranë Universitetit Shën Qirili dhe Metodi në Shkup.</p> <p>Në shkurt të vitit 2021 kandidatja ka ndjekur në punëtori dhe trajnim online për OpenQuake Engine (modulet 1 dhe 2) e mbështetur nga fondacioni GEM.</p> <p>Kandidatja gjithashtu ka të shprehur interesim për anëtarësim në shoqata profesionale. Nga viti 2019 është anëtare e Institucionit të inxhinierëve të Maqedonisë – Klubi i inxhinierëve të rinj. Nga viti 2021 është anëtar i odës së Arkitektëve dhe Inxhinierëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut.</p>
---------------------------	--

2. REALIZIMET SHKENCORE, PROFESIONALE, PEDAGOGJIKE TË KANDIDATIT NGA ZGJEDHJA E FUNDIT DERI NË DITËN E KONKURRIMIT

Veprimtaria edukativo-arsimore

Almir Rushiti	<p>Në kuadër të veprimtarisë edukativo-arsimore të UNT-së, në fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, kandidati Almir Rushiti mban ushtrime në ciklin e parë të studimeve në programin studimor Ndërtimtari / Konstruksione.</p> <p>VËRREJTJE: Për të bashkërenditur aktivitetet mësimore të lëndëve (ligjëratave, ushtrimeve, literaturës së përdorur, aspekteve pedagogjike të mësimdhënies,...), profesori i lëndës i ka kërkuar asistentit të jetë prezent në orët e ligjëratave. Asistenti nuk ka respektuar kërkesën, ndërsa ushtrimet i ka zhvilluar bazuar në njohuritë dhe kompetencat e veta.</p>
Lisa Jusufi	<p>Në kuadër të veprimtarisë edukativo-arsimore të UNT-së, në fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, kandidatja Lisa Jusufi nga tetori i vitit 2019 ka ndihmuar procesin mësimor, në bazë vullnetare, gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve në lëndët mësimore të ciklit të parë dhe të dytë të programit studimor Ndërtimtari / Konstruksione, edhe atë në lëndët “Metoda e elementeve të fundme”, “Analiza jolineare e elementeve vijore”, “Teoria e strukturave 1” dhe “Teoria e strukturave 2”.</p>

Veprimtaria kërkimore-shkencore/ Veprimtaria profesionale-artistike

Almir Rushiti	<p>Kandidati Mr.Sc. Almir Rushiti gjithsej ka botuar 5 punime shkencore nga fusha e konstruksioneve ndërtimore, prej të cilave 0 punime shkencore në revista shkencore me impakt-faktor (faktor ndikues), 0 punime në revista shkencore ndërkombëtare dhe 5 punime në botime të konferencave ndërkombëtare, rajonale dhe vendore.</p> <p>VËRREJTJE: Ka refuzuar të angazhohet në projektin e fakultetit për zhvillim të literaturës mësimore moderne për nevojat e studentëve (literaturë për lëndët në të cilat ka qenë i angazhuar si asistent). Refuzimin për bashkëpunim e bëri në debat të hapur të një takimi pune drejtuar profesorit të lëndës ku dhe vetë ka qenë i angazhuar si asistent. Pas refuzimit të tij për bashkëpunim me profesorin e fushës shkencore “Teoria e konstruksioneve” (për të cilën fushë është shpallur ky konkurs për asistent), profesori refuzon kategorikisht bashkëpunimin e mëtutjeshëm me Mr.Sc. Almir Rushiti, dhe ka kërkuar largimin e kandidatit si asistent nga lëndët e tij.</p>
Lisa Jusufi	<p>Kandidatja Mr.Sc. Lisa Jusufi gjithsej ka botuar 3 punime shkencore nga fusha e inxhinierisë sizmike dhe teorisë së strukturave, prej të cilave 0 punime shkencore në revista shkencore me impakt-faktor (faktor ndikues), 0 punime në revista shkencore ndërkombëtare dhe 3 punime në botime të konferencave ndërkombëtare, rajonale dhe vendore.</p>

Veprimtaria profesionale-zbatuese dhe veprimtaria me interes më të gjerë

Almir Rushiti	<p>Kandidati Mr.Sc. Almir Rushiti brenda periudhës së angazhimit të deritanishën në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës pranë Universitetit Nënë Tereza – Shkup, ka treguar angazhim aktiv në veprimtarinë profesionale, përkatësisht ka qenë i angazhuar në projektimin e 3 objekteve ndërtimore, në revizionin e 2 projekteve tjera si dhe në mbikëqyrjen e punimeve ndërtimore të 1 objekti individual.</p> <p>VËRREJTJE: Nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e kolektivit akademik për bashkërenditjen e aktiviteteve lidhur me punët për riakreditimit të programeve studimore të fakultetit. Nuk ka ndihmuar kolektivin akademik gjatë aktiviteteve grupore. Ka shmangur dhe ka refuzuar marrjen e detyrave për ta ndihmuar kolektivin me punët e riakreditimit të programeve studimore të fakultetit.</p>
Lisa Jusufi	<p>Kandidatja Mr.Sc. Lisa Jusufi deri tani ka pasur angazhim aktiv edhe në veprimtarinë profesionale, përkatësisht ka qenë e angazhuar si bashkëpunëtore në projektimin e 9 objekteve të ndryshme inxhinierike, në kuadër të të cilave përfshihen objekte individuale, objekte shumëkatëshe si dhe komplekse afariste-hotelierike-banesore.</p>

Aktivitete plotësuese që kanë të bëjnë me veprimtarinë edukative-arsimore, kërkimore-shkencore, profesionale-zbatuese dhe veprimtarinë e interesit më të gjerë, të rëndësishme për zgjedhjen, titujt e punimeve, projekteve etj, paraqiten në forma tabelare në Shtojcën e këtij referati.

3. PËRFUNDIM DHE PROPOZIM

Në bazë të dokumentacionit të përgjithshëm të dorëzuar nga kandidatët, komisioni recensues në vijim prezanton në mënyrë tabelare dallimet kryesore ndërmjet dy kandidatëve, përkatësisht:

Kriteri	Mr.Sc. Almir Rushiti	Mr.Sc. Lisa Jusufi	Sipas këtij kriteri, i jepet përparësi kandidatit
Nota mesatare e studimeve Baçelor	8.93	9.38	Mr.Sc. Lisa Jusufi
Nota mesatare e studimeve Master	9.66	10.00	Mr.Sc. Lisa Jusufi
Nota mesatare e studimeve të doktoratës	Nuk ka informacion	10.00	Mr.Sc. Lisa Jusufi
Niveli i bashkëpunimit kolegial	Jo i kënaqshëm (shpjegimi i dhënë në vërejtjet më lartë)	I kënaqshëm	Mr.Sc. Lisa Jusufi
Mosha e kandidatit	28	26	Mr.Sc. Lisa Jusufi
Njohja e gjuhës angleze	Vlerësimi B- sipas testimit APTIS	Vlerësimi 92/100 sipas testimit TOEFL	Mr.Sc. Lisa Jusufi

Bazuar në:

- rezultatet e paraqitura në tabelën e mësipërme,
- dokumentacioni të përgjithshëm të dorëzuar nga kandidatët, dhe
- njohjes personale të kandidatëve

komisioni recensues konstaton përparësitë e kandidates Mr.Sc. Lisa Jusufi për përzgjedhje.

Prandaj, sipas të lartpërmendurës, Komisioni ka nderin që Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës pranë Universitetit „Nënë Tereza” në Shkup t’i propozojë që Mr.Sc. Lisa Jusufi TË ZGJEDHET në thirrjen asistent-doktorant në fushën shkencore Teoria e konstruksioneve (20706).

**KOMISIONI
RECENSUES:**

Prof. Dr. Zekirija Idrizi Kryetar d.v. _____

Prof. Dr. Zhivko Bozhinovski Anëtar d.v. _____

Doc. Dr. Idaver Huseini Anëtar d.v. _____

SHTOJCA

DREJT RAPORTIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN EDUKATIVO-ARSIMORE, MËSIMORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati: Almir Rushiti

Institucioni: Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Universitetin Nënë Tereza - Shkup

Fusha shkencore: Teoria e konstruksioneve (20706)

VEPRIMTARIA EDUKATIVO-ARSIMORE

Nr.	Titulli i aktivitetit:	Pikët
1.	<p>Zhvillim i mësimit në: Ciklin e 1-rë të studimeve në Universitetin Nënë Tereza - Shkup</p> <p style="text-align: center;"><u>Programi Studimor: Ndërtimtari – Konstruksione</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mekanikë - Statikë – Ushtrime (2018/19, 2019/20) x 3 orë x 0.9 pikë = 5.4 pikë 2. Mekanika e materialeve – Ushtrime (2018/19, 2019/20) x 3 orë x 0.9 pikë = 5.4 pikë 3. Mekanika e fluideve – Ushtrime (2018/19, 2019/20, 2020/21) x 3 orë x 0.9 pikë = 8.1 pikë 4. Teoria e strukturave 1 – Ushtrime (2018/19, 2019/20) x 2 orë x 0.9 pikë = 3.6 pikë 5. Teoria e strukturave 2 – Ushtrime (2018/19, 2019/20) x 2 orë x 0.9 pikë = 3.6 pikë 6. Mekanika e dherave – Ushtrime (2019/20, 2020/21) x 2 orë x 0.9 pikë = 3.6 pikë 7. Fundamente – Ushtrime (2019/20, 2020/21) x 3 orë x 0.9 pikë = 5.4 pikë 8. Fizikë ndërtimore – Ushtrime (2020/21) x 3 orë x 0.9 pikë = 2.7 pikë 	37.8
Gjithsej		37.8

VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE

Nr. rendor	Titulli i aktivitetit:	Pikët
1.	Abstrakte dhe punime të botuara në konferenca vendore, rajonale dhe ndërkombëtare 5 x 1	5
	Gjithsej	5

VEPRIMTARIA PROFESIONALE-ZBATUESE

Nr. rendor	Titulli i aktivitetit:	Pikët
1.	Përgatitje e dokumentacionit të projektit (projekt kryesor) – bashkëpunëtor 3 x 2	6
2.	Revizion i projektit – bashkëpunëtor – 2 x 0.5	1
3.	Aktivitete ekspertësh: mbikqyrje (mbikqyrje e projektit – inxhinier kryesor) – 1x1	1
	Gjithsej	8

REFERENCAT E KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE

VEPRIMTARIA	Pikët
VEPRIMTARIA EDUKATIVO-ARSIMORE	37.8
VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE	5
VEPRIMTARIA PROFESIONALE- ZBATUESE	8
Gjithsej	50.18

KOMISIONI RECENSUES:

Prof. Dr. Zekirija Idrizi Kryetar d.v. _____

Prof. Dr. Zhivko Bozhinovski Anëtar d.v. _____

Doc. Dr. Idaver Huseini Anëtar d.v. _____

SHTOJCA

DREJT RAPORTIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN EDUKATIVO-ARSIMORE, MËSIMORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati: Lisa Jusufi

Institucioni: Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Universitetin Nënë Tereza - Shkup

Fusha shkencore: Teoria e konstruksioneve (20706)

VEPRIMTARIA EDUKATIVO-ARSIMORE

Nr.	Titulli i aktivitetit:	Pikët
1.	<p>Zhvillim i mësimit në: Ciklin e 1-rë të studimeve në Universitetin Nënë Tereza - Shkup</p> <p style="text-align: center;"><u>Programi Studimor: Ndërtimtari – Konstruksione</u></p> <p>1. Teoria e strukturave 1 – Ushtrime (2021/22) x 2 orë x 0.9 pikë = 1.8 pikë</p> <p>2. Teoria e strukturave 2 – Ushtrime (2020/21) x 2 orë x 0.9 pikë = 1.8 pikë</p> <p>Ciklin e 2-të të studimeve në Universitetin Nënë Tereza - Shkup</p> <p style="text-align: center;"><u>Programi Studimor: Ndërtimtari – Konstruksione</u></p> <p>1. Metoda e elementeve të fundme – Ushtrime (2019/20, 2020/21) x 2 orë x 0.9 pikë = 3.6 pikë</p> <p>2. Teoria e plasticitetit të elementeve vijore – Ushtrime (2019/20, 2020/21) x 2 orë x 0.9 pikë = 3.6 pikë</p>	10.8
	Gjithsej	10.8

VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE

Nr. rendor	Titulli i aktivitetit:	Pikët
1.	Abstrakte dhe punime të botuara në konferenca vendore, rajonale dhe ndërkombëtare 3 x 1	3
	Gjithsej	3

VEPRIMTARIA PROFESIONALE-ZBATUESE

Nr. rendor	Titulli i aktivitetit:	Pikët
1.	Përgatitje e dokumentacionit të projektit (projekt kryesor) – bashkëpunëtor 9 x 2	18
	Gjithsej	18

REFERENCAT E KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE

VEPRIMTARIA	Pikët
VEPRIMTARIA EDUKATIVO-ARSIMORE	10.8
VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE	3
VEPRIMTARIA PROFESIONALE- ZBATUESE	18
Gjithsej	31.8

KOMISIONI RECENSUES:

Prof. Dr. Zekirija Idrizi Kryetar d.v. _____

Prof. Dr. Zhivko Bozhinovski Anëtar d.v. _____

Doc. Dr. Idaver Huseini Anëtar d.v. _____

REFERAT
PËR ZGJEDHJE TË NJË BASHKËPUNËTORI ASISTENT NË FUSHËN MËSIMORE –
SHKENCORE NORMAT NË ORGANIZIMIN HAPËSINOR (20102),
NË FAKULTETIN E NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS TË UNIVERSITETIT “NËNË
TEREZA” SHKUP

Në bazë të konkursit të shpallur nga ana e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, i shpallur në web-Faqen Universitare si dhe gazetat “Koha” dhe “Sloboden pecat” në datën 01.07.2021, për zgjedhje të një bashkëpunëtori në thirjen bashkëpunëtor asistent në fushën mësimore – shkencore NORMAT në Organizimin Hapësinor, Këshilli Mësimor-Shkencor në mbledhjen e mbajtur në datë 30.12.2021 formoi Komisionin Recenzues për zgjedhje të një mësimdhënësi me këtë përbërje:

1. Doc. Dr. Radmilla Tomovska, docent – kryetar
2. Doc. Mr. Armir Ferati - docent – anëtar
3. Doc. Mr. Vebi Fazliu - docent – anëtar

Komisioni recenzues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, paraqet këtë:

RAPORT

Në konkursin e shpallur në portalin ditor “Koha” dhe “Sloboden pecat” në datën 01.07.2021, për zgjedhje të një bashkëpunëtori në thirjen bashkëpunëtor asistent në fushën mësimore – shkencore NORMAT NË ORGANIZIMIN HAPËSINOR, në afatin e paraparë konkuruan kandidatët:

1. Mr. Valmir Dalipi

TË DHËNAT BIOGRAFIKE DHE ARSIMIMI

Kandidati Mr. Valmir Dalipi ka lindur në datë 18.09.1991 në Strugë, Republika e Maqedonisë së Veriut Arsimin e mesëm e ka përfunduar në Gjimnazin “Dr. Ibrahim-Temo” në Strugë . Studimet e ciklit të parë i ka përfunduar në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara – Arkitekturë, pranë Universitetit Shtetërorë të Tetovës, në vitin 2014 me notë mesatare 8.09 dhe fitoi titullin Baccalaureus i Projektimit..

Pas mbarimit të ciklit të parë të studimeve ka regjistruar ciklin e dytë në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi”, Fakulteti i Arkitekturës, Shkup. Në vitin 2017 mbron temën e magjistraturës me titull "Objekt I integruar multifunksional kulturor në qytetin e Strugës" dhe merr titullin Magjistër inxhinier i arkitekturës me note mesatare 8.88.

Nga viti 2021 ndjek studimet e ciklit të tretë në drejtimin e Arkitekturës dhe urbanizmit në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup , Fakulteti i Arkitekturës, Shkup

Pas përfundimit të studimeve në vitin 2017 themelon ndërmarje për projektim, dhe mbikqyrje të objekteve arkitekturore. Kompania është përfshirë në një numër të madh projektesh dhe realizime të objekteve me destinime të ndryshme, kryesisht me karakter banimor shumëbanesor dhe individual.

Gjatë angazhimit në kompaninë private ka aplikuar metodat më të reja teknologjike në përpilimin e dokumentacioneve teknike, realizimin e objekteve, rikonstruimin dhe adaptimin duke ju përshtatur nevojave të tregut dhe kërkesave bashkohore.

VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE, PROFESIONALE DHE PEDAGOGJIKE

Mr. Valmir Dalipi në vitin 2018 angazhohet si asistent në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup në lëndët e projektimit arkitektonik të objekteve banimore (në semestrin 1, 2 dhe 3), shoqërore (semestri 5,6), industriale (semestri 5) dhe në lëndët e Konstruksioneve Arkitektonike. (në semestrin 4 dhe 5) gjegjësisht Projektim Arkitektonik 1, 2, 3, 5 dhe 6, Studio Arkitektonike 3, 4 dhe 5, dhe Konstruksione Arkitektonike 2 dhe 4 . Rezultatet e evaluimit për vitin akademik 2019/2020 dhe 2020/2021 paraqesin notë pozitive në kontinuitet për veprimtarinë mësimore-arsimore të kandidatit.

Gjatë angazhimit si kuadër i Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës kandidati merr pjesë aktive në organizimin dhe strukturimin e programit studimor Arkitekturë dhe Dizajn dhe bën pjesë në komisionin:

Komisioni për përpilimin e programit për riakreditim

Bazuar nga përvoja profesionale e fituar nga sektori privat kandidati mer pjesë aktive në komisione të ndryshme edhe në realizimin e procedurave furnizuese që kanë të bëjnë me planifikimin, projektimin dhe monitorimin e realizimit të punëve ndërtimore dhe projektuese për nevojat e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup.

Si asistent në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, si pjesë e stafit akademik, kandidati Mr. Valmir Dalipi është pjesmarrës në organizimin e puntorive arkitektonike, projekteve, ekspozitave dhe prezentimeve në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup si:

- Organizator i ekspozitës studentore “FACE EXPO 2019”, Qendra Informative Kulturore në Shkup, Maj 2019
- Vizitë profesionale e studentëve dhe stafit akademik në Hotelin “Holiday Inn” në Shkup dhe ligjeratë publike në kuadër të lëndës Projektim Arkitektonik 5, Mars 2019, Shkup
- Vizitë profesionale e studentëve dhe stafit akademik në Fabrikën për ambalazhimin e ujit “Maya” në Dibër dhe ligjeratë publike në kuadër të lëndës Projektim Arkitektonik 5, Prill 2019, Dibër
- Ligjeratë e hapur me temë “Efikasiteti energjetik i dritareve” me përfaqësues nga ndërmarja “Rehau” me seli në Gjermani dhe përfaqësi në Shkup, Nëntor 2019, Shkup

VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE DHE VEPRIMTARIA PROFESIONALE ARTISTIKE

Mr. Valmir Dalipi si bashkëpunëtor-asistent në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, përveç angazhimit në procesin arsimor është i angazhuar edhe në procesin kërkimor-shkencor. Mr. Valmir Dalipi në fushën kërkimore-shkencore ka punuar temën e magjistraturës me titull " Objekt I integruar multifunksional kulturor në qytetin e Strugës ".

Merr pjesë në disa konferenca ndërkombëtare dhe nacionale, punishte dhe ligjerata publike mbi arkitekturën dhe ndërtimtarinë edhe atë:

- **“Art dhe mirëkuptim”** (më shumë kujdes për trashëgiminë arkitekturore) në Strugë dhe Ohër në bashkëpunim me studentë dhe profesorë nga Universiteti I Tetovës në Strugë, 05/2016.
- **Articulation of urban requests according to local population: municipality of Ilinden** in association with representatives of Polis University and Faculty of Architecture Belgrade, në Shkup 09/2015.
- **Inclusive open spaces for socialization and recreation: Outdoor gym and public gardens** in association with representatives of URBEGO and Co-PLAN, Shkup 10/2014
- **3rd International Conference Towards Sustainable Development (TSD 2019)**, I organizuar nga Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup, 2019

- **4th International Conference Towards Sustainable Development (TSD 2019)**, I organizuar nga Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup, 2020
- Participated at **SHARE ARCHITECTS SKOPJE 2020**, February 13, në Shkup 02/2020.
- Participated **“Digital teaching skills in higher education”** – Mother Theresa University Skopje, në Shkup 09/2020.

Punime shkencore:

- **Thermal bridges as a problem toward energy efficiency and sustainable architecture, their inadequate application in the construction of individual residential buildings in the Republic of Northern Macedonia.**

Mr.Valmir Dalipi

[Skopje, North Macedonia] Conference: 4th

International Conference Towards Sustainable Development (TSD2020). At: Skopje Volume: Vol. 5 (1/2021).

- **Sustainable Bioclimatic Strategies Applicable on Buildings on Sloped Terrain in Mountain Touristic Settlements.**

Dr.Radmila

Tomovska; Mr.Valmir Dalipi

[Skopje, North

Macedonia] Conference: 4th International Conference Towards Sustainable Development (TSD2020) At: Skopje Volume: Vol. 5(2/2021)

VEPRIMTARIA PROFESIONALE APLIKATIVE

Kandidati Mr.Valmir Dalipi gjatë studimeve dhe pas mbarimit të studimeve është angazhuar në shumë projekte ideore dhe kryesore. Fillimisht në bashkëpunim me ndërmarje lokale, pastaj me themelimin e ndërmarjes për projektim, inxhinieri, mbikqyrje dhe konsultime “VD ARCHITECTS” ku paraqitet si themelues prej vitit 2017 e cila vepron edhe aktualisht ku kandidati si arkitekt dhe mbikqyrës i autorizuar ka projektuar, dhe është kujdesur mbi realizimin e shumë objekteve arkitekturore Duke vepruar në shoqërinë e mësipërme projektuese, Mr.Valmir Dalipi në kuadër të veprimtarisë profesionale aplikative paraqitet si projektant kryesorë, mbikqyrës dhe bashkëpunëtor në projektet:

1. 2021 Projekt kryesor – Objekt banimi shumëbanesor P+3, Strugë

Statusi: Në realizim, Arkitekt kryesor: Mr. Valmir Dalipi

2. 2021 Projekt kryesor – Objekt banimi individual P+1, Strugë

Statusi: Në realizim, Arkitekt kryesor: Mr. Valmir Dalipi

3. 2021 Projekt kryesor – Objekt banimi individual P+1, Strugë

Statusi: Në realizim Arkitekt kryesor: Mr. Valmir Dalipi

4. 2021 Projekt kryesor – Objekt banimi individual P+1, fsh. Dollogozhdë, Strugë

Statusi: Në realizim Arkitekt kryesor: Mr. Valmir Dalipi

5. 2021 Projekt kryesor – Objekt banimi individual P+1, fsh. Shum, Strugë,

Statusi: I realizuar Arkitekt kryesor: Mr. Valmir Dalipi

- 6. 2021** Projekt ideor – Apartament, Dizajn Enterieri, Strugë,
Statusi: I pa realizuar , Arkitekt kryesor: Mr. Valmir Dalipi
- 7. 2021** Mbikqyrës kryesor i autorizuar – Objekt banimi individual P+1, fsh. Veleshtë, Strugë,
Statusi: Në realizim, Arkitekt mbikqyrës kryesor: Mr. Valmir Dalipi
